



BPrAL AAB
INSTITUCIONI I ARSIMIT UNIVERSITAR

FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

DEFINIMI DHE MENAXHIMI I PROJEKTIT DHE FUSHËVEPRIMTARIS SË PRODUKTIT

LËNDA: MENAXHIMI I PROJEKTËVE TË TI-së

Ligjërues: MSc. Artan DRESHAJ

Proceset e menaxhimit të fushëveprimtaris

- ▶ Udhëzuesi PMBOK përcakton pesë proceset e projektit që mbështesin zonën e njohurive të quajtur menaxhimi I fushëveprimtaris së projektit.

Proceset e menaxhimit të fushëveprimtaris	Përshkrimi
Mbledhja e kërkesave	përcaktimi dhe dokumentimi i nevojave të aksionareve për të menaxhuar siç duhet pritjet e tyre
Definimi i fushëveprimtaris	Një përshkrim i detajuar i projektit dhe produktit. Ajo duhet të përcaktojë se çfarë pune do të përfshihet dhe nuk do të përfshihet në projekt.
Krijimi I strukturës ndarëse të punëve (Work Breakdown Structure - WBS)	Dekompozim ose ndarja e rezultateve të projektit madhor në komponentë më të vogla dhe më të menaxhueshme.
Verifikimi I fushëveprimtaris	Konfirmimi dhe pranim formal se fushëveprimtaria e projektit është e saktë, e plotë, dhe mbështet qëllimin e projektit.
Kontrolli I fushëveprimtaris	Sigurimi që kontrollet janë vendosur për të menaxhuar ndryshimet e propozuara të fushëveprimtaris dhe si të tilla janë pranuar. Këto procedura duhet të komunikohen dhe kuptohen nga të gjitha palët e interesit së projektit.

PLANIFIKIMI I FUSHËVEPRIMTARIS

- ▶ Dështimi për të përcaktuar se çfarë është pjesë e projektit, si dhe çfarë nuk është, mund të rezultojë në punë të panevojshme të kryera për të krijuar produktin e projektit dhe në këtë mënyrë të çojë në tejkalim të dy komponentëve, orarit dhe buxhetit.
- ▶ Planifikimi i fushëveprimtaris fillon me një proces që zyrtarisht autorizon menaxherin e projektit dhe ekipin për të zhvilluar një plan të menaxhimit të fushëveprimtaris.
- ▶ Në kushtet e metodologjisë së projektit të TI-së, ky autorizim është dhënë pasi që projekti është pranuar formalisht dhe fondet janë angazhuar për zhvillimin e skemës së projektit dhe planit të sponsorit të projektit ose klientit.
- ▶ Planifikimi i fushëveprimtaris, megjithatë, është një proces për përcaktimin dhe dokumentimin e punës të projektit.

PLANIFIKIMI I FUSHËVEPRIMITARIS




Figure 5.1 Scope Management Plan

Deklarata e Punës (The Statement of Work - SOW)

- ▶ Një deklaratë e punës (SOW) është një përshkrim narrativ i produkteve, shërbimeve, apo sistemit të informacionit.
- ▶ Për projektet e brendshme, SOW duhet të lidhë së bashku nevojën e biznesit me kërkesat specifike ose pritjet e projektit.
- ▶ Për projektet e jashtme, një organizatë mund të krijojë një SOW që përfshin specifikimet, sasi të, standardet e cilësisë, apo kërkesat e performancës që mund të ju dërgohen ofertuesve të ardhshëm.

Deklarata e fushëveprimtaris

- ▶ Deklarata e fushëveprimtaris dokumenton nevojat e sponsorit te projektit dhe pritjet.
- ▶ Për shembull, le të themi se ne jemi konsulentë të jashtëm të punësuar për të zhvilluar një aplikacion elektronike, e-commerce për një bankë.
- ▶ Le të supozojmë se jemi autorizu që të përgatishim deklaratën e fushëveprimtaris e cila do të përfshijë:
 1. Zhvilloni një strategji proaktive të e-commerce që identifikon proceset, produktet dhe shërbimet që do të ofrohen përmes World Wide Web.
 2. Zhvillimi i një sistemi të aplikimit që mbështet të gjitha proceset, produktet, dhe shërbimet e identifikuara në strategjinë e e-commerce.
 3. Integron sistemin e aplikimit me sistemin ekzistues për planifikim të burimeve të bankës.
- ▶ Është shumë e rëndësishme definimi se çka nuk do të jetë pjesë e projektit dhe fushëveprimtaris së tijë. Në shembullin e mësipërm jashtë fushëveprimtaris së projektit do të jetë:
 1. Vlerësimi i teknologjisë dhe organizimi i mjedisit aktual,
 2. Menaxhimi i burimeve të klientëve dhe komponentëve të data mining

PËRKUFIZIMI I FUSHËVEPRIMTARIS SË PROJEKTIT

- ▶ Fushëveprimtaria e një projektit, duhet të përkufizohet në terma të rezultateve që ekipi duhet të ofrojë.
- ▶ Këto rezultate mund të ndahen në rezultate të orientuara në projekte dhe rezultate të orientuara në produkt.
- ▶ Kjo ndarje i mundëson ekipit një përkufizim më të qartë të punës që do të realizohet dhe përmirëson gjasat e caktimit të saktë të burimeve dhe vlerëson kohën dhe koston për plotësimin e punës.
- ▶ Një përkufizim i qartë i rezultateve të projektit vendos shpresa të qarta dhe pajtueshmëri midis të gjitha palëve të interesuara të projektit.

PËRKUFIZIMI I FUSHËVEPRIMTARIS SË PROJEKTIT - Orientimi në projekt

- ▶ Rezultatet e orientuara në projekte, mbështesin menaxhmentin e projekteve dhe proceset zhvillimore të TI-së që janë të përcaktuara në metodologjinë e projektit të teknologjisë së informacionit (ITPM).
- ▶ Rezultatet e orientuara në projekt gjithashtu përfshijnë rezultate të veçanta të tilla si një studim i sistemeve aktuale, përkufizim të kërkesave, dhe dokumentimin e dizajnit të sistemit informativ.
- ▶ Rezultatet e orientuara në projekt kërkojnë kohë dhe burime dhe, për këtë arsye, duhet të jenë pjesë e planit të përgjithshëm të projektit dhe buxhetit.
- ▶ Të gjitha të rezultatet e projektit duhet të kenë një përkufizim të qartë dhe konciz. Një mënyrë për të komunikuar rezultatet e projektit është për të krijuar një tabelë me përkufizime të rezultateve (deliverable definition table DDT).
- ▶ Në vijim do të paraqitet tabela e rezultateve për shembullin e krijimit të e-comerc për bankën.

Table 5.2 Deliverable Definition Table

<i>Deliverable</i>	<i>Structure</i>	<i>Standards</i>	<i>Approval Needed By</i>	<i>Resources Required</i>
Business case	Document	As defined in the project methodology	Project sponsor	Business case team and office automation (OA) tools
Project charter and project plan	Document	As defined in the project methodology	Project sponsor	Project manager, project sponsor, and OA tools
Technology and organizational assessment	Document	As defined in the project methodology	Project manager and project sponsor	Bank's systems analysts users, case tool, and OA tools
Requirements definition	Document	As defined in the project methodology	Project manager	System analyst, users, case tool, and OA tools
User interface	Prototype	As defined in the user interface guidelines	Project sponsor	System analyst, programmer, users, and integrated development environment (IDE)
Physical and technical design	Document	As defined in the project methodology	Project manager and project sponsor	System analyst, programmer, and case tool
Application system	Files and database	As defined in the project methodology	Project sponsor	Programmers, system analysts, network specialists, program development tools, and relational database management system
Testing plan	Document	As defined in the project methodology	Project manager	System analysts and OA tools
Testing results	Document	As defined in the test plan	Project manager	Programmers, system analysts, and OA tools
Change management and implementation plan	Document	As defined in the project methodology	Project manager	Systems analysts and OA tools
Training program	User documentation and training class	As defined in the implementation plan	Project manager and project sponsor	Trainers, documentation writers, and OA tools
Final report and presentation	Document	As defined in the project methodology	Project sponsor	Project sponsor, project manager, and OA tools
Project evaluations and lessons learned	Document	As defined in the project methodology	Project manager and senior	Project team, knowledge management system

PËRKUFIZIMI I FUSHËVEPRIMTARIS SË PROJEKTIT - Orientimi në produkt

- ▶ Edhe pse sistemi i aplikimit e-commerce është e listuar si një rezultat i orientuar në projekt, ne ende nuk kemi një ide të qartë se çfarë saktësisht do të dorëzohet tek klienti në këtë pikë në projektin tonë.
- ▶ Në përgjithësi, sistemi i aplikimit do të jetë rezultati më i madh i projektit dhe do të kërkojë më shumë kohë dhe burime për tu përfunduar.
- ▶ Identifikimi i tipareve dhe funksionalitetit të sistemit të aplikimit (dhe kompleksiteti i tyre) do të jetë shumë i rëndësishëm për të vlerësuar kohën dhe koston e prodhimit të këtij rezultat.

PËRKUFIZIMI I FUSHËVEPRIMTARIS SË PROJEKTIT - Orientimi në produkt

- ▶ **Mjetet e definimit të fushëveprimtaris së orientuar në produkt** - Fushëveprimtaria e produktit fokusohet në identifikimin e karakteristikave dhe funksionalitetin e sistemit të informacionit që do të zbatohet.
- ▶ Një mjet i dobishëm për rafinimin e kufirit të fushëveprimit dhe përcaktimin se çfarë sistemi do të krijojë është një mjet modeli që quhet **data flow diagram (DFD)**.
- ▶ Një DFD është një model i proceseve që shfrytëzohet për një periudhë të gjatë dhe është mësuar shpesh në sistemet e analizës dhe kurset e projektimit.
- ▶ DFD, paraqet një përfaqësim të nivelit të lartë të sistemit që ka një proces dhe përshkruan të gjitha flukset hyrëse dhe dalëse të të dhënave dhe informacioneve midis sistemit dhe entiteteve të jashtme të tij.
- ▶ Entitetet e jashtme janë të përfaqësuar zakonisht nga një katror dhe mund të jenë njerëz, departamentet, ose sisteme të tjera që ofrojnë apo marrin flukse të të dhënave.
- ▶ Shigjeta përfaqësojnë rrjedhën drejtuar të të dhënave në mes të entiteteve të jashtme dhe të sistemit. Një shembull i një DFD për sistemin tonë bankar të e-commerce është dhënë në vijim.

PËRKUFIZIMI I FUSHËVEPRIMITARIS SË PROJEKTIT - Orientimi në produkt - (2)




Figure 5.4 Context Level Data Flow Diagram (DFD)

PËRKUFIZIMI I FUSHËVEPRIMTARIS SË PROJEKTIT - Orientimi në produkt - (3)

- ▶ Një tjetër mjet i dobishëm për përkufizimin e shtrirjes së produktit është përdorimi diagram të rastit (case diagram), i cili është përdorur në sistemet e orientuara në objekte si pjesë e Unified Modeling Language (UML).
- ▶ Përderisa Jacobson (Jacobson, Cristerson et al. 1992) paraqiti *use case* si mjet për zhvillimin e softuerit, një *use case diagram* mund të ofrojë një model të nivelit të lartë për përcaktimin, verifikimin, dhe arritjen e pajtueshmërisë mbi fushëveprimin e produktit.
- ▶ *Use case diagram* është një diagram relativisht i thjeshtë në kuptimin e simboleve dhe sintaksës, por ajo është një mjet i fuqishëm për identifikimin e funksioneve kryesore ose tipareve të sistemit dhe përdoruesit e ndryshëm apo sistemet e jashtme që bashkëveprojnë me sistemin.
- ▶ Aktorët janë njerëzit (përdoruesit, klientët, menaxherët, etj.) ose sistemet e jashtme (p.sh., sistem ERP i bankës) që ndërveprojnë, apo përdorin, sistemin.
- ▶ Një *use case*, nga ana tjetër, përshkruan funksionet kryesore që sistemi duhet të kryejë për një aktor apo aktorët.




Figure 5.5 Use Case Diagram

VERIFIKIMI I FUSHËVEPRIMTARIS SË PROJEKTIT

- ▶ Pasi që fushëveprimtaria e projektit është përcaktuar, ajo duhet të verifikohet dhe të pranohet formalisht nga sponsori i projektit dhe palët tjera të përshtatshme.
- ▶ Verifikimi I fushëveprimtaris së projektit është procesi i menaxhimit të fushëveprimtaris që ofron një mekanizëm për të siguruar që rezultatet e projektit janë plotësuar sipas standardeve të përkrahura në DDT (**deliverable definition table**).
- ▶ Më poshtë gjendet një listë që tregon se rezultatet janë kompletuar dhe që janë kompletuar saktë.
 - ▶ MOV-A është MOV e projektit e përcaktuar qartë dhe a ka pasur pajtueshmëri për këtë?
 - ▶ Rezultatet - A janë rezultatet të prekshme dhe të verifikuëshme? A e mbështesin ato MOV të projektit?
 - ▶ Standardet e cilësisë - A ekziston sistemi I kontrollit për të siguruar që puna jo vetëm që ka përfunduar, por ka përfunduar duke përmbushur standardet specifike?
 - ▶ Piketa - Milestones - A janë piketat të përcaktuara për çdo rezultat?
 - ▶ Shqyrtimi dhe pranimi-A janë të dy palët të qarta në pritjet e tyre?

Kontrollimi i procedurës për ndryshimin e fushëveprimtaris

- ▶ Procedura për ndryshimin e fushëveprimtaris duhet të jetë e miratuar para se puna aktuale për projektin të fillon.
- ▶ Ajo mund të jetë pjesë, ose të paktën është cekur në skemën e projektit në mënyrë që ajo si e tillë të ju komunikohet të gjitha palëve të interesuara të projektit.
- ▶ Kjo procedurë duhet të lejojë identifikimin dhe trajtimin e të gjitha kërkesave për ndryshime në fushëveprimin e projektit.
- ▶ Kërkesa për ndryshimin e fushëveprimtaris mund të bëhet, dhe ndikimi i çdo kërkesë mbi projektin mund të vlerësohet.
- ▶ Pastaj, mund të nxjerrët një vendim nëse do të pranohet apo refuzohet ndryshimi.
- ▶ Një procedurë për ndryshim të fushëveprimtaris mund të përfshijë një formë kërkesë për ndryshim.

Scope change request form

Requestor name: _____ Request date: _____

Request title: _____ Request number: _____

Request description:

Justification:

Possible alternatives:

<i>Impacts</i>	<i>Alternative 1</i>	<i>Alternative 2</i>	<i>Alternative 3</i>
Scope			
Schedule			
Resources required			
Cost			

Recommendation:

Authorized by

Date

Figure 5.6 Scope Change Request Form

Ruajtja e ngjarjeve për kërkesat e ndryshimit të fushveprimtaris

<i>Request Number</i>	<i>Request Title</i>	<i>Date of Request</i>	<i>Requested by</i>	<i>Priority (L, M, H)</i>	<i>Authority to Approve Request</i>	<i>Expected Response Date</i>	<i>Scope Change Approved? (Y/N)</i>

Figure 5.7 Scope Change Request Log

Përfitimet e kontrollit të fushëveprimit

- ▶ Përfitimi më i rëndësishëm i procedurave të kontrollit të ndryshimeve të fushëveprimit është se ata mbajnë menaxherin e projektit në kontrollë të projektit.
- ▶ Më konkretisht, ata lejojnë menaxherin e projektit për të menaxhuar dhe kontrolluar orarin e projektit dhe buxhetin.
- ▶ Procedurat e kontrollit të fushëveprimit gjithashtu lejojnë ekipin e projektit për të qëndruar të fokusuar dhe në rrugën e duhur për sa i përket përmbushjes piketave-milestones të saj sepse nuk kanë për të kryer punë të panevojshme.

DEFINIMI DHE MENAXHIMI I PROJEKTIT DHE FUSHËVEPRIMTARIS SË PRODUKTIT

► **PYETJE PËR KËTË KAPITULL?**